



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 03/11

Prishtinë, më 23.03.2011, ora 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Mungoi: Hasime Krasniqi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Agim Krasniqi - Drejtor i Buxhetit, Ekrem Hoxha nga ART, Raif Preteni dhe Ramiz Krasniqi nga ZRRUM, Jeton dhe Adelina Sopi nga KKTK, Lumnije Krasniqi dhe Faton Fetoshi nga IGJK, Alexander Beetz, Teki Shala dhe Njomza Ilazi nga GIZ, si dhe monitorues nga Zyra e Presidentit dhe KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të mbajtur më datë 15.03.2011;
3. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2011;
5. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Mbeturina për vitin 2011;
6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2011;
7. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.
Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të mbajtur më datë 15.03.2011

Procesverbali miratohet pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011

Kryetarja, shpjegoi shkurtimisht kërkesën buxhetore të ART-së, të dërguar me shkrim Kuvendit të Kosovës.

Ekrem Hoxha, prezantoi kërkesën për punësimin e pesë punëtorëve shtesë dhe ndarjen e shumës prej 75.000€, të cilët do të rrisin kapacitetet profesionale dhe ekzekutuese të ART-së. Si dhe nevoja për një buxhet shtesë prej 125.000€ për projekte kapitale, ku përfshihet ngritja e një platforme softuerike e cila do të mundësojë detektimin e pajisjeve telekomunikuese, me ç'rast vetëm në vitin e parë ART-ja do të kontribuojë në buxhetin e konsoliduar me 4 milionë € plus, ndërsa në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ata kërkuar një buxhet shtesë prej 52.000 mijë €.

Kryetarja, theksoi se mungesa e raportit të shpenzimeve, paraqet hendikep dhe nuk mundëson për të parë realizimin e buxhetit nëpër kategori të këtij autoriteti, që do na ndihmonte në vendosjen për buxhetin vijues.

Agim Krasniqi, sa i përket ART-së për shkak të kërkesave ligjore për bartjen e disa përgjegjësisë nga Ministria e Infrastrukturës, e që do të duhet të bartet edhe me buxheti edhe staf i që ka kryer këto punë, dhe nuk ka pasur mundësi për rritjen e stafit.

Xhevdet Neziraj, kërkoi sqarim konkrete për disa shpenzime të shërbimeve që ka planifikuar të realizojë ART-ja, si “shërbimet arsimore dhe trajnuese”, “shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse”, si dhe “shërbimet kontraktuese të kohëpaskohshme.

Sali Asllanaj, në mungesë të raportit për punën e ART-së dhe si rezultat mungesës së informatave të duhura, është vështirë të vlerësohet puna e këtij Rregullatori, megjithatë ai e çmoi dhe përgëzoi ART-në, për aksionet që i kanë ndërmarrë kundër operatorëve ilegal.

Muhamet Mustafa, vlerësoi kërkesat të arsyeshme, por së vështirë të mbulohen për shkak se është vështirë të merren paratë nga një organizatë e ti jepen këtij autoriteti. Sa i përket pesë pozitive të reja që i kërkon ART-ja, pyeti se çfarë kualifikimesh kërkohen dhe çfarë pune është vlerësuar se do të kryejnë këta punëtorë të ri?

Agim Krasniqi, njoftoi se në dokumentin kornizë ata i kanë njoftuar të gjitha agjencionet buxhetore që të përshtatin legjislacionin brenda mundësive buxhetore, pasi që vetëm plani për veprim partneriteti evropian kushton 900 milionë €, ndërsa i tërë buxheti është 1 miliardë e 400 milion €. Është duhet të rishikohen se cilat janë nevojat më reale dhe nga analiza e kërkesës së ART-së duke u bazuar në kuptimin e politikave buxhetore nuk kanë mundur të gjejnë hapësirë dhe si rrjedhojë propozoi që për disa pozita të krijohen shërbime të përbashkëta.

Naser Osmani, propozojë që të pranohen tre pozita që do të paguhen në bazë të një koeficienti krahasues me të punësuarit e tjerë të lëmive të ngjashme, në kuadër të këtyre pozitave të mos jenë shërbimi postar dhe auditori.

Muhamet Mustafa, u pajtua me propozimin e z. Osmani, sepse meqë janë pozita të rëndësishme, mungesa e të cilave do të ndikonte në humbjen me të mëdha buxhetore se sa është kostoja e tyre, atëherë është përgjegjësi e jona që të bëjmë zgjidhje.

Ekrem Hoxha, sa i përket përgjegjësive, theksoi se është një interpretim i njëanshëm i ligjit dhe i gabuar dhe varshmëria nga një memorandum i mirëkuptimit nga vullneti i Ministrit, e cenon pavarësinë e Rregullatorit. Në pyetjen për shërbimet arsimore dhe trajnuese, njoftoi se ka zbritje për 25.000 mijë €, krahasuar me vitin paraprak, ndërsa sa i përket shërbimeve kontraktuese të kohëpaskohshme, ka të bëjë me blerjen e ekspertizës së huaj nga ART-ja, për shkak të mungesës të ekspertizë të caktuar për përcaktimin e kostos tek operatori, rasti i konfiskimit të aseteve të operatorëve ilegal, ku duhet ekspertizë e veçantë, që ART-ja nuk mund ta bëjë. Sa i përket pozitave të reja, si inxhinier i teknologjisë informative, zyrtarë për kode ndërkombëtare, zyrtar për monitorim dhe menaxhim të stacionit fiks radio-monitorues është nevojë e domosdoshme që ART-ja ti përmbush detyrat e përcaktuara me ligj.

Kryetarja, kërkoi nga z. Hoxha, që të sjellë strukturën e të punësuarve dhe koeficientet për të punësuarit e ART-së.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetarja, konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- I. Komisioni u pajtua për rritjen e numrit të punëtorëve për tre pozita në bazë të propozimit të ART-së.

4. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2011

Kryetarja, shpjegoi për kërkesat e ARH-së, që dallojnë shumë nga ajo që është paraparë në projektbuxhetin e vitit 2011.

Halit Gara, njoftoi se kërkesat e ARH-së janë të bazuar në ligjin të cilin janë të obliguar që ta zbatojnë, e me buxhetin e ndarë aktualisht nuk ua mundësojnë t'i kryejnë obligimet ligjore. Mungojnë tre pozita që janë me rëndësi të jashtëzakonshme, pa të cilat nuk mund të kryhet aktiviteti kryesor i Autoritetit. Ndarja e buxhetit për pagat ka paraqitur vështirësi në angazhimin e ekspertëve të lëmisë siç është rasti konkret për licencim. Kërkesa tjetër për projekte kapitale është e bazuar po ashtu në ligj, ku kërkohet kontraktimi i një pale të tretë kompetente për testim të pajisjeve hekurudhore.

Agim Krasniqi, shfaqti mendimin se ky buxheti i ndarë është i mjaftueshëm, që ARH-ja të funksionojë brenda tregut të Kosovës të fushës së caktuar dhe nuk duhet të lejohet staf tjetër administrativ, pasi që punët tjera për financa apo prokurim, duhet të kenë shërbime të përbashkëta.

Duda Balje, pyeti përfaqësuesin e ARH-së se sa kilometra hekurudhë janë funksionale në Kosovë, sa punëtorë i kanë të punësuar dhe çfarë është bilanci i këtij autoriteti deri me tani?

Halit Gara, në përgjigjen e parafolësës, njoftim se janë 333 km që shfrytëzohen, pasi që një pjesë nuk shfrytëzohet për shkak të pengesave në zhvillim. Janë 8 persona që punojnë, por tregoi që ky Autoritet ka nënshkruar memorandum me Ministrinë e Infrastrukturës për çështjet administrative-financiare si dhe me Komisionin e Minierave.

Muhamet Mustafa, ndau mendimin se me këtë nivel operimi dhe në këtë situatë është problem të rritet administrata dhe të ketë rritje buxhetore për këtë autoritet.

Kryetarja, meqenëse se në këtë kërkesë nuk ka detalizim të vendeve të punës, nuk ka detalizim as për mallra dhe shërbime se ku do të shpenzohen si dhe një arsyesmëri se për çka ju duhen shpenzimet kapitale dhe duke pasur parasysh kufizimet buxhetore, i sugjeroi autoritetit përkatës të arsyetohen mirë kërkesat dhe të shikohen mundësitë e plotësimit të tyre në rishikim të buxhetit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetarja, konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- I. Komisioni nuk përkrahu kërkesat buxhetore shtesë të ARH-së. Buxheti i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, mbetet i njëjtë siq është përfshirë në Projektligjin për Buxhetin 2011.

5. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Mbeturina për vitin 2011

Kryetarja, shkurtimisht shpjegoi kërkesat e kësaj zyre që janë më të shumta se sa janë përfshirë në projektbuxhetin e vitit 2011.

Raif Preteni, tregoi që janë dy arsye që ZRRUM-i kërkon shtim të buxhetit për vitin 2011: vendimi i Qeverisë për ngritje pagash për shërbyesit civil prej 30% dhe shtimi i stafit prej tre punëtorëve me vendim të Kuvendit me përbërjen e kaluar.

Agim Krasniqi, njoftoi që rritja e pagave për 30% është aplikuar për të gjithë të punësuarit që janë me sistem të koeficienteve, ndërsa të tjerët që kanë dalë jashtë sistemit të rregullt, nuk janë përfshirë pasi që kanë paga më të larta.

Kryetarja, njoftoi se për këtë rregullator, në të kaluarën është bërë një përmirësim i dukshëm i pozitave të të gjithë punëtorëve. Ajo që nuk mund të vendosim tani në kërkesat e tyre për çështjen e pagave, pasi që nuk kemi një skemë të pagave të këtij Rregullatori për vitin 2010.

REKOMANDIM

- I. Komisioni nuk përkrahu kërkesat buxhetore shtesë të ZRRUM-së. Buxheti i Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Mbeturina mbetet i njëjtë siq është përfshirë në Projektligjin për Buxhetin 2011.

6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi anëtarët me kërkesat shtesë të KKTK-në të paraqitura edhe në formë të shkruar.

Jeton, prezantoi dhe arsyetoi kërkesat shtesë të cilat njëkohësisht ishin të pasqyruara në kërkesën me shkrim që i është dorëzuar Kuvendit.

Agim Krasniqi, theksoi se që buxheti i ndarë është i mjaftueshëm, mirëpo ka nevojë që brenda institucionit të rishikohen pozicionet e tyre. Sa i përket çështjes së veturave ai tha që Qeveria e ka një vendim për mos blerje të veturave, dhe KKTK-ja duhet t'i drejtohet Ministrisë së Administratës Publike, për sigurimin e vetëm një veture.

Naser Osmani, theksoi se shpenzimet e domosdoshme për ngrohje dhe qiranë duhet të parashihen dhe të kryhen me një automatizëm. Po ashtu propozoi që këtij institucioni t'i lejohen 20.000 € për blerjen e dy veturave.

Latif Gashi, theksoi se që të gjitha kërkesat e agjencioneve ishin të arsyeshme dhe nuk duhet bërë dallime në mes tyre, por duhet të analizohen dhe të studiohen me kujdes kërkesat e të gjitha agjencioneve buxhetore.

Sali Asllanaj, kërkoi sqarim për strukturën e organizative dhe punën që e kryen ky institucion si dhe pyeti se sa komunikojnë me qendrat tjera për trashëgimi kulturore që gjenden jashtë Prishtinës?

Adelina Sopi, tha që jemi të cunguar në kryerjen e punëve si pasojë e mjeteve buxhetore, rasti i mungesa e veturës dhe nevojave tjera operative.

Agim Krasniqi, sugjeroi që e çështja e veturave të zgjidhet përmes kërkesës drejtuar Ministrisë së Administratës Publike, për të ofruar veturat funksionale, ku ndërmjetësuese do të jetë edhe M. Financave.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni përkrahu kërkesën shtesë të KKTK-së për shpenzime komunale në vlerë prej 3.000 €.
- II. Për blerjen e veturave, Komisioni rekomandoi që Ministria e Financave në konsultim me Ministrinë së Administratës Publike që të sigurojë dy vetura funksionale të Qeverisë për nevojat të KKTK-së
- III. Kërkesa tjera për mallra dhe shërbime (Pagesa e Qirasë për gjashtë, Derivate për lëndë djegëse dhe ngrohje) do të trajtohen me rastin e rivlerësimit të buxhetit për vitin 2011.

7. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011

Kryetarja, kërkoi nga përfaqësuesit e IGJK-së të prezantojnë dhe të arsyetojnë kërkesën e tyre.

Faton Fetoshi, theksoi se buxheti i këtij institucioni në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti është zvogëluar për 101 mijë 987 €. Sa i përket pagave, edhe pse IGJK-ja bën pjesë në sistemin gjyqësor, punëtorët e IGJK-së trajtohen si shërbyes civilë, ndërsa kërkesa e tyre është që të trajtohen si kategoritë tjera të sistemit gjyqësor, të cilët edhe i trajtojnë.

Agim Krasniqi, njoftoi se ky institucion ka kompletuar strukturën dhe pajisjeve për punë është vitin e kaluar. Sa i përket buxhetit për në mallra dhe shërbime është analizuar shpenzimi që kanë bërë vitin e

kaluar. Çështja e ndarjes së pagave është zgjidhur në përputhje me ligjet në fuqi, dhe si përfundim ky institucion mund ta kryejë punën e vet më buxhetin që u është ndarë.

Naser Osmani, propozoi që komisioni në ditët e ardhshme, pas leximit të parë të projektligjit, ta trajtojë edhe njëherë kërkesën e IGJK-së pa prezencën e tyre dhe të merret vendimi përfundimtar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

Kryetarja, mbështeti propozimin e deputetit z. Osmani që në mbledhjet e ardhshme pas leximit të parë të buxhetit të shqyrtohet edhe një herë kërkesa e IGJK-së në mënyrë që të merret vendimi përfundimtar.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Kërkesa e Institutit Gjyqësorë do të rishqyrtohet dhe do të merret vendimi në një mbledhje tjetër të Komisionit, pas leximit të parë të Projektligjit të Buxhetit 2011.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ